

## INTERVISTË ME MYRVETE DRESHAJ

Prishtinë | Data: 10 tetor 2005

Kohëzgjatja: 106 minuta

Të pranishëm

- Fehmi Hajra (Intervistuesi)
- Myrvete Dreshaj (E intervistuar)

*Kjo intervistë është realizuar nga QKSGJ - Qendra Kosovare për Studime Gjinore*

**Fehmi Hajra:** Do të filloja intervistën rreth fëmijërisë suaj. Ju lutem a mund të më tregoni se ku keni lindur?

**Myrvete Dreshaj:** Quhem Myrvete Dreshaj. Tash edhe Baliu, e lindur në Vrellë të Istogut, më 1966.

**Fehmi Hajra:** Ku jeni rritur?

**Myrvete Dreshaj:** Kam lindur në Vrellë, ndërsa jam rritur dhe shkolluar në Pejë.

**Fehmi Hajra:** Ju lutem, a mund të na tregoni çfarë ju kanë punuar prindërit?

**Myrvete Dreshaj:** Nëna ime ka qenë amvise, por amvise e shkolluar për kohën, sepse ka pasur të kryer shkollën e mesme të ulët, por nuk ka vazhduar sigurisht, sepse dihet se si kanë qenë rrethanat atëherë dhe sesi është pritur në një rreth fshatar të shkollohet një femër më tutje. Por ajo ka qenë baza ime për jetë dhe për të dashur shkollën dhe për të ditur rëndësinë e mësimi. Ndërsa babën e kam pasur kurbetçi domethënë mërgimtar, gati pas katër pesë vjetëve që kam lindur unë. Do të thotë jam rritur me nanën, me mësimet e nanës, me tepër sesa të babës.

**Fehmi Hajra:** A mund të na tregoni për shkollimin e prindërve tuaj? Ju e përmendët pak nanën tuaj.

**Myrvete Dreshaj:** E përmenda nanën, do të thotë që ka qenë një arsimdashëse edhe pse amvise, të cilën ndjenjë na ka përcjellë edhe ne fëmijëve për ta ruajtur si amanetin më të shenjtë dhe të fundit të saj, ndërsa babai im për gati gjithë jetën e gjallë të nanës sime ka qenë në mërgim. Këtu, domethënë në Kosovë ka kryer dy vjet të gjimnazit, kurse në mërgim ka vazhduar dhe e ka bërë shkollën e plotë të mesme, do të thotë në kurbet, si janë organizuar ato mësimet shtesë për punëtorët me punë të përkohshme, ka përfunduar të mesmen, dhe pastaj nuk ka hezituuar të investojë për shkollimin tonë sepse e ka dashur shumë shkollimin, e ka ndër nevojën për t'u brumosur më tej edhe vetë dhe për të përfunduar aspiratat e tij përmes ne fëmijëve, e sidomos përmes meje si fëmija më i madh.

**Fehmi Hajra:** Ju e përmendët shkollimin tuaj. A mund të na tregoni për shkollimin tuaj?

**Myrvete Dreshaj:** Unë e kam kryer shkollën fillore në Pejë, në shkollën "Xhemajl Kada". Aty afër e kam pasur edhe shtëpinë. Kam kryer pastaj gjimnazin "11 Maj" po në Pejë.

Kur flas për shkollën fillore është diçka e këndshme, e lirë dhe shumë mbresëlënëse, ndërsa kur hyj për të mesmen, aty fillon edhe aktiviteti im politik, ilegal, kombëtar a si do t'i themi tashi, cilido term që të na duket më i përshtatshëm. Dhe këtu fillon edhe diçka tjetër, jo vetëm mësimi por edhe preokupimi dhe angazhimi im i përgjithshëm, si i shqiptarëve të tjerë në luftën për liri. Sigurisht,

mosha është shumë, shumë e re, por kjo nëna ime për të cilën ju fola më herët, e cila sot është e ndjerë gati që 23 vjet, përcillte “Radio Kukësin”, atëherë kur gati absolutisht nuk e kuptoja çka do të thotë një radio tjetër, pos “Radio Prishtinës”.

Sigurisht, kjo radio ka pasur shtrirje te valëve atëherë... dhe unë përmes saj, më mirë se çdo kund tjetër, mësova historinë tonë dhe fatin tragjik të ndarjes sonë. Kur kishte ndonjë emision për personalitetet e shumta historike ajo më thoshte, "A, ky është për Ismajl Qemalin, dëgjoje sa bukur po flet; ky është për Mic Sokolin, Bajram Currin, Isa Boletinin e të tjerë," do të thotë të gjitha këto, pra ato fillimet e mia të para që të mishërohem me personalitete kombëtare të cilët kanë bërë për çështje të Kosovës, ka qenë nga ndikimi i nanës sime.

Por mbi të gjitha mua si fëmijë më kujtohet që në “arkën e pajës” ajo e mbante gjithmonë librin “Kosova: djep i shqiptarizmit” të autorit Hamit Kokallari. Nëna i mbante gjithmonë të mbështjellura kopertinat, sigurisht për çështje sigurie, ndërsa kur unë e merrja dhe ia largoja ato i bëja me dhjetëra pyetje, sepse ato ishin me shqiponjën gjysmëkrenare, domethënë ishte vetëm gjysma e flamurit tonë.

Shpesh më thoshte, “Mos e prek atë se s’ban me e prekë, se është e ndalueme dhe mos i trego dikujt që e kam unë këtu,” po mirë i thosha, “Ne e kemi flamurin me dy krahët e shqiponjës e pse këtu ka vetëm gjysmën e saj,” ndërsa ajo thoshte “Kur të rritësh ke me kuptu këtë”. Gjithmonë e kam ndier se nëna ime ruante si peng diçka të çmuar në arkë bashkë me çezin e saj.

Edhe më vonë baba im, si mërgimtar që ishte ka qenë një atdhetar dhe është një atdhetar i mirë që e kishte kuptuar drejt çështjen e Kosovës dhe shqiptarëve në ish-Jugosllavi, sillte literaturë nga Gjermania. Më kujtohet sikur sot vepra “Tradhtarët,” pastaj “Titistët,” “Shtypi botëror rreth ngjarjeve në Kosovë,” “Mbi ngjarjet në Kosovë” etj. Pastaj ai e sillte revistën e ilustruar “Shqipëria e Re” dhe emblema e shenja të ndryshme kombëtare, këto të fundit, të gjitha fill pas ngjarjeve të vitit 1981.

Nëna ime i ruante ato shumë, dhe kur unë pastaj e krijova vetëdijen se cila ishte vlera e këtyre librave sigurisht i mora nga arka e nanës, i lexova duke mbajtur edhe shënime mes fletoresh dhe i nxora në qarkullim tek shokët e shoqët e mia të shkollës dhe aty filluam bazat e para të një celule ilegale të organizimit ...

**Fehmi Hajra:** Mandej keni filluar fakultetin?

**Myrvete Dreshaj:** Deri këtu kam një varg peripetish...

**Fehmi Hajra:** Prej shkollës së mesme keni pasur një shkëputje?

**Myrvete Dreshaj:** Po është e vërtetë kam pasur një shkëputje ...

**Fehmi Hajra:** Do të flasim më vonë për këtë.

**Myrvete Dreshaj:** Po. Mirë.

**Fehmi Hajra:** Domethënë mandej keni vazhduar studimet?

**Myrvete Dreshaj:** Pas burgut politik që e mbajta, unë vazhdova studimet, do të thotë nuk ishte lehtë të vazhdohen studimet, sepse të regjistrohesh në një fakultet të Universitetit të Prishtinës, në kohën kur kërkoheshin karakteristikat nga bashkësitë lokale ishte shumë e vështirë do të thotë dhe për neve që ishim ba “me njolla”, si u pëlqente, në atë kohë, disave të na thonin, ishte shumë vështirë se s’kishte bashkësi lokale, e sidomos bashkësia ime lokale e cila lëshonte një lloj si çertifikimi se ti i plotëson kushtet për t’u regjistruar, kushtet ideo-politike ish-jugosllave dihet.

Dhe kjo është një çështje taman ... një peripeti shumë e madhe që të mund të regjistroheshe. Për mua kur kam marrë indeksin e Universitetit të Prishtinës, ka qenë sikurse kur kam diplomuar, ndoshta entuziazmi nuk ka qenë aq i madh kur kam diplomuar sa ka qenë kur e kam marrë një indeks të Universitetit të Prishtinës.

**Fehmi Hajra:** Kur ka ndodhur kjo?

**Myrvete Dreshaj:** Kjo ka ndodhur me ... 1988. Po në vitin akademik 1988\89. Ndërsa nga burgu isha liruar më 1987, në gusht. Një vit, një ferr i veçantë për të përfunduar maturën, sepse nuk na pranonte absolutisht asnjë shkollë për të përfunduar vitin e katërt. Kudo që shkonim na thonin se jemi irrendentistë, nacionalistë, s’keni të drejtë shkollimi sepse jeni kundër këtij sistemi.

Unë çka bëra, babai im më kishte nxjerr një letërnjoftim sa isha unë në burg si banore e Prizrenit dhe një çertifikatë shëndetësore, dihet me anë të lidhjeve, që kam qenë e sëmurë për tri vjet dhe nuk kam mundur të vazhdoj shkollën e mesme, kështu që më 1 shtator të 1987 unë fillova si nxënëse e rregullt në gjimnazin e Prizrenit, në drejtimin që kisha: laborante e biologjisë.

Drejtor shkolle ishte një serb atëherë, po megjithatë tri javë shkova si nxënëse e rregullt, me aspiratën që ta kryej dhe të regjistroj mjekësinë, sepse edhe ashtu kemi qenë me gjitha pesa në shkollën e mesme. Por, pas këtyre tri javësh, në orë mësimi, erdhi drejtori i shkollës me një dokument përpara dhe thirri, "Myrvete Dreshaj, kush është?" e njihte shqipen bukur mirë. Them, "Unë jam," ndërsa ai shton, "Prej sot nuk je nxënëse e këtij gjimnazi, je e përjashtuar sepse je nacionaliste e këtij sistemi". U ktheva tashti prej Prizrenit prapë në Pejë dhe vazhduan kështu edhe disa muaj deri sa autoritetet e gjimnazit "11 Maji" të Pejës mezi u bindën, jo pa një kërcënim nga ana e prindit tim, që të na pranojnë në provime me korrespondencë dhe të përfundojmë vitin e katërt.

**Fehmi Hajra:** Mandej keni magjistruar?

**Myrvete Dreshaj:** Po, më pas kam ardhur në Universitetin e Prishtinës dhe faktikisht jam legjitimuar si studente e rregullt vetëm kur serbët zyrtarisht mbyllën Universitetin e Prishtinës për studentët shqiptarë dhe ne kaluam në fakultetet-shtëpi.

Këtu kam kryer në afatin e rregullt, duke diplomuar në vitin 1993. Më 1994 menjëherë kam regjistruar studimet e shkallës së tretë po në degën e Letërsisë. Kam përfunduar studimet e shkallës së tretë, kam magjistruar dhe tash jam afër në mbrojtjen e doktoratës.

**Fehmi Hajra:** Keni qenë e punësuar dhe për sa kohë?

**Myrvete Dreshaj:** E punësuar? Kur po mendoni?

**Fehmi Hajra:** Në këtë periudhën që po flasim.

**Myrvete Dreshaj:** Jo. Vetëm pas përfundimit të fakultetit kam punuar për dy vjet në fshatin Bardh i Madh, komuna e Fushë Kosovës, e më pas jam zgjedhur asistente në Fakultetin e Mësuesisë për grupin e lëndëve Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, dhe kam punuar rreth gjashtë vjet. Tash, është viti i tretë që jam ligjëruese e lëndës Histori e Letërsisë Shqipe në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Prishtinës.

**Fehmi Hajra:** Ju lutem a mund të na tregoni kur për herë të parë keni marrë pjesë në politikë dhe cilat kanë qenë rrethanat?

**Myrvete Dreshaj:** Shiko tashi ta definojmë atë çka është politikë dhe të marrim moshën kur ne përpiqeshim ta bënim atë. Unë e thashë edhe në fillim kur solla dilemën çka është një aktivitet që mund të quhet kombëtar njëhërë e pastaj politik. Ato janë ndoshta nocione kur njeriu krijon një personalitet më komplet...

Por fillet e para në lëvizjen kombëtare të çdo individi, të themi tash kushtimisht lëvizje kombëtare, mendoj se fillojnë atëherë kur njeriu fillon të bëjë diçka më shumë se të tjerët, dhe ajo e bërë dallohet prej reagimeve spontane të pjesës tjetër të shoqërisë. Prandaj unë u përpoqa të shpjegoj momentin kur nëna ime ruante në arkën e saj librat ilegalë, do të thotë libra që ishin të ndaluar dhe rreptësisht dënoheshe po të gjindeshin në një familje shqiptare që jetonte në Kosovë. Fillet e mia mund t'i gjej aty. E pastaj rrethi i shoqeve dhe shokëve në gjimnaz sigurisht se e ka bërë te vetën. Debatimi për tema kombëtare, ai ka qenë hapi vendimtar që unë të futem në një aktivitet që edhe unë të jap pjesën time në lëvizjen për çlirimin e shqiptarëve.

**Fehmi Hajra:** Këto debate kanë qenë të organizuara apo ...?

**Myrvete Dreshaj:** Sigurisht që njëherë kanë qenë të organizuara në nivelin e bisedave mes shoqesh, shokëve, e më pas janë krijuar celulat e para, ndërsa më vonë kemi krijuar grupin ilegal. Do të thotë, pak nga pak jemi zgjeruar derisa e kemi formuar organizatën, siç e kemi quajtur ne organizata patriotike "Ideali", do të thotë një organizatë e të rinjve gjimnazistë të shkollës së mesme në Pejë.

**Fehmi Hajra:** Kryesisht kush ka marrë pjesë?

**Myrvete Dreshaj:** Kryesisht, ne kemi marrë pjesë... kur jemi dënuar është quajttë “grupi i vajzave” sepse kemi qenë shtatë vajza dhe dy djem. Udhëheqëse e grupit ka qenë Have Shala, një shoqe imja dhe Robert Rasaj, do të thotë këta dy kanë qenë udhëheqës të grupit, ne të tjerët kemi qenë anëtarë: unë, Zyrafete Muriqi, Hydajete Kelmendi, Zoge Shala ... edhe emra të tjerë ...

**Fehmi Hajra:** Cili ka qenë synimi i kësaj organizate ?

**Myrvete Dreshaj:** Ashtu sikur Rilindja Kombëtare që ka bërë ngritjen e vetëdijes kombëtare shqiptare, sigurisht edhe viti 1981 na ka vetëdijësuar më tepër dhe mendoj se gjithë ai akumulim i përpjekjeve të shqiptarëve që është bërë pas Luftës së Dytë Botërore në këtë vit sikur është mbledhur dhe ka shpërthyer e rrezatuar njëkohësisht, duke reflektuar gati gati në secilën familje shqiptare.

Këtu kemi me të madhe krijimin e grupeve ilegale, kemi aktivitetin konkret të nxjerrjeve të revistave të ndryshme, publikimeve të ndryshme, shpërndarjeve të trakteve të ndryshme etj. Edhe ne nuk kemi mundur të dalim jashtë këtyre rregullave për të cilat lexonim dhe për të cilat dëgjonim ilegalisht apo dëgjonim prej njëri tjetrit.

Dihet se pas '81 e këndej UDB-ja dhe sigurimi shtetëror jugosllav ka pasur atë aspiratën që të mbajë orë politike çdo kund nëpër shkolla, gjimnaze dhe në konkretisht jam ballafaquar me këto ligjërata politike që na mbanin inspektorë të sigurimit nëpër klasa, ndërsa pas tyre pyetej, “A ka kush kundër diçka?” Dhe e di që nuk kam qenë ajo nxënësja e urtë që vetëm kam përlur kryet dhe kam thënë, “Ok! Kjo është në rregull!” Por kam bërë pyetje të ndryshme, si: “Pse kemi nevojë ne të çohemi në protestë? Pse s’janë plotësuar kërkesat tona? Pse s’kemi pas të drejtë në përdorimin e flamurit, Luftën Nacional Çlirimtare e kemi bërë me popujt tjerë?!” etj.

Dhe unë e di që në evidencën e UDB-së kam hyrë qysh atëherë, më 1981 e '82, kur kam qenë nxënëse e vitit të parë dhe e vitit të dytë të gjimnazit, sigurisht për shkak të pyetjeve që kam bërë. Pastaj kanë qenë planprogramet e shkollimit, të cilat na cungoheshin, dhe profesori i letërsisë nuk kishte të drejtë të na shpjegojë Kadarenë, të na shpjegojë Dritëro Agollin, bile bile as Migjenin se le të tjerët dhe sigurisht kam qenë nxënëse e mirë që e kam njohur këtë fushë dhe kanë qenë pyetjet e mia që ju kam bërë për këtë temë njerëzve nga sigurimi. Për të gjitha këto dihet që nuk kemi marrë përgjigje asnjëherë, e megjithatë unë i kam bërë ato pyetje.

**Fehmi Hajra:** Po më intereson cili ka qenë motivimi juaj për këto aktivitete në atë moshë rinore?

**Myrvete Dreshaj:** Ne e kemi parë që nuk jemi të barabartë, do të thotë tash veç kishim arritur një moshë të pjekurisë që të kuptojmë se s’jemi të barabartë me popujt e tjerë në ish-Jugosllavi, që trajtohemi si qytetarë të rendit të dytë a të tretë dhe të tjera e të tjera. Kemi parë që nuk e kemi të drejtën e punësimit siç e kanë të tjerët, kemi parë që gjendja jonë ekonomike është krejt më e ndryshme sesa e fqinjëve tanë që ishin serbë apo të nacionaliteteve të tjera. Do të thotë ishin krejt këto gjëra konkrete të përditshmërisë sonë që ne i shihnim me sy dhe me të cilat e shihnim veten që dallojmë shumë prej të tjerëve.

**Fehmi Hajra:** A ka pasur ndonjë ngjarje gjatë fëmijërisë suaj apo rinisë që ka pasur të bëjë drejtpërdrejtë me familjen tuaj e cila ka ndikuar që ju të jeni aktive në politikë?

**Myrvete Dreshaj:** Unë e thashë edhe pak më herët që fëmijëria është e lidhur ndoshta edhe me atë pjesën e rritës sime dhe rrjedhojat e saj. Mua prindi më ka munguar vazhdimisht dhe sigurisht shpesh kam shtruar pyetjen, “Pse mos ta kem sikur të tjerët prindin te shtëpia dhe ai ta ketë një punë këtu, e jo të jetë një kurbetçar që mund ta shoh një a dy herë në vit, e të tjera?”

Nëpër familjet tradicionale shqiptare ishte e vështirë të mos i kishe të dy prindërit gjithherë në shtëpi dhe vazhdimisht kishe një ndjenjë se të mungonte një pjesë sigurisht, ndërsa tek shoqet e shokët e mi kam vrejtur që prindërit e tyre absolutisht, ishin në një gjendje shumë të rëndë, ndërsa fundi i fundit ekonomikisht ne kemi qenë më mirë, pse shpirtërisht mua më ka munguar prindi ka qenë diçka tjetër.

Unë kam pasur shokët e shoqet e mia të cilët kanë bërë udhë deri në 18 km në këmbë për të ardhur në gjimnazin e Pejës, e të cilët i ka mbajtur vetëm vullneti për shkollën. Ndërsa kemi pasur rrethe të tjera me fshatra serbe të cilat tërë kohën kanë pasur autobusin që ka qarkulluar, ndërsa në pjesën e Lugut të Baranit, ku unë e kam pasur shoqen time më të mirë, ajo e ka bërë atë rrugë këmbë edhe nëpër borë edhe nëpër shi dhe në takimet e pushimeve mes orëve bënim vetvetiu pyetjet se, “Pse duhej të bëhej ky dallim, nxënës është edhe ai që vjen prej një fshati serb e nxënës janë edhe këta të tjerët, pse disa të jenë të privilegjuar e pjesa tjetër e diskriminuar?”

Kemi pasur edhe pjesë të tjera që të shtyn të jesh i vendosur në qëndrimet tua, që ti të shpirtërohesh me to. Ne gjithmonë e kemi pasur atë aspiratën që për 28 nëntorin të bëjmë diçka, një festë, një program artistik, kulturor apo të përgatitim qoftë edhe vetëm një recital, edhe pse festë e ndaluar nga pushteti ne jemi mbledhur dhe e kemi kryer ceremoninë për këtë ditë të caktuar dhe për të tjera si kjo.

Dhe një rast shumë vendimtar ka qenë kur gjimnazi ynë kishte përvjetorin dhe na thanë që duhet të zgjedhen nxënësit më të mirë të gjimnazit që të përgatitin një program kulturo-artistik sepse këtë përvjetor bëhej miqësimi i gjimnazeve të rajoneve dhe në këtë kohë nga drejtoria na thanë se përfshihej edhe një prej gjimnazeve të Shqipërisë, ndoshta ka qenë një provokim, çuditërisht, dhe ne shumë entuziast një muaj të plotë bëmë një program shumë të mirë, por që ditën e fundit, në provën gjenerale, ku ishte prezent krejt udhëheqja e shkollës, na thanë se programi nuk mund të jepet sepse ka shumë nacionalizëm, irrendentizëm, shovenizëm, gjithë ato terme që ishin diskriminuese atëherë dhe e di që këtu ka qenë një hap tjetër vendimtar për të dalë haptazi, për të shkruar dhe shpërndarë trakte, proklamata, parulla nëpër gjimnazin e Pejës, nëpër rrugë, në mes të qytetit e në rrethinë.

Ne i kemi ngjitur edhe vetë drejtorit të gjimnazit në derë të zyrës një trakt, i kemi ngjitur edhe pjesës tjetër të udhëheqjes, kemi shpërndarë nëpër korridore, banka të nxënësve, do të thotë kemi shprehur revoltën në mënyrën më të rreptë që ne e kemi menduar për kohën.

**Fehmi Hajra:** Ju e përmendët lëvizjen kombëtare ose patriotike siç është quajtur grupi “Ideali” në Pejë. A mund të na tregoni më shumë për këtë? Kush e ka organizuar? Çfarë efekti ka pasur në rrjedhjen e aktiviteteve e ngjarjeve të tjera?

**Myrvete Dreshaj:** Neve na ka ra të dëgjojmë, do të thotë edhe të lexojmë më vonë se grupet ilegale në Kosovë kanë qenë të organizuara dhe shpesh njëra ka qenë celulë e tjetrës. Sidomos tash kemi të botuara dy vepra të zotëri Ethem Çekut, “Mendimi politik rreth Lëvizjes Ilegale në Kosovë” dhe “Shekulli i Ilegales”, do të thotë organizatat e mëdha si LPK-ja ose LKÇK-ja kanë pasur edhe celulat e veta të organizimit, një pjesë e tyre ka rënë në burg, ndërsa pjesa tjetër ka vazhduar aktivitetin, domethënëse prej asaj bërthame është krijuar bërthama tjetër.

Të them të vërtetën tash kur bisedojmë me miqtë e me shoqet, krejt çuditën sesi ne pa e pasur një lidhje të këfillë, pa qenë bërthamë e ndonjëre prej këtyre organizatave të mëdha, kemi arritur të organizohemi dhe të veprojmë, sesi kemi mundur dhe si kemi ditur, por të frymëzuar prej asaj që shihnim gjatë gjykimeve të cilat mbaheshin për atdhetarët që vepronin në Lëvizje, prej qëndrimit krenar dhe burrëror që mbanin ata, të cilat gjykime pas ’81 e këndeje ishin mjaft të shpeshta, ne jemi inspiruar dhe jemi organizuar vetë. Nuk kemi pasur asnjë lidhje me këto organizata, sepse personalisht nuk kemi njohur asnjë prej anëtarëve të tyre, por në frymën e tyre ne kemi organizuar, këtë Organizatën tonë Patriotike “Ideali”.

Më vonë e kemi kuptuar që termi organizatë është diçka shumë më e madhe, megjithëse ne në momentin e formimit kemi aspiruar që do ta bëjmë shumë të madhe. Ky ishte një grup ilegal, do të do thotë në frymën e grupeve që janë organizuar për kohën, i cili merrej me shkrimin e parullave, propagandimin, shpërdarjen e literaturës, shkruarjen dhe shpërndarjen e pamfleteve etj.

Furnizimin me literaturë ilegale e bëja unë. Atë literaturë e sillte fshehtas, në motorin e veturës, babai im kur vinte në pushim nga Gjermania. Unë e shpaloja, do të thotë ajo ishte gjithëherë e mbështjellë mirë për të mos u dëmtuar, e lexoja dhe më pas ua shpërndaja shokëve dhe shoqeve të grupit, por edhe të tjerëve, edhe ata pastaj e shpërndanin dorë më dorë. Në frymën e kësaj literature dhe në bazë të asaj çka shihnim ne hartonim një trakt, do të thotë një proklamatë të cilën e shpërndanim, bile bile kohët e fundit para se të burgoseshim i patëm bërë këtë aktivitet gati të përditshëm. S’kishte muaj që Peja nuk zbardhte me trakte, të cilat sillnin gjendjen reale të shqiptarëve në ish-Jugosllavi dhe kërkesat e tyre jetike.

**Fehmi Hajra:** Cili ka qenë vendi, lokacioni?

**Myrvete Dreshaj:** Në Pejë.

**Fehmi Hajra:** A konsideroni ju se ka ndodhur ndonjë veprim, si rezultat i kësaj ngjarjeje? Nëse po, çfarë ka qenë ai?

**Myrvete Dreshaj:** Po shiko tashi, çdo gjë e ka lidhshmërinë e vet, ndoshta... diçka e shkëputur vështirë se e bën atë brumin e vet, por... le të numrojmë disa nga efektet, nëse mund t'i theksoj ato më kryesoret: Fillimisht ne ishim vetëm një grup i gjimnazistëve, të themi të vertetën, ishim nxënësit më të mirë të gjimnazit. Pra, gati të gjithë kemi qenë nxënës shembullorë dhe nuk ka qenë pak për një gjimnaz, i cili kishte traditë sidomos në mësimdhënie, që t'i burgosë nëntë nxënësit e vet dhe t'i dënojë me shumë vjet burg.

Ç'është e vërteta para neve ka qenë edhe një grup tjetër i nxënësve të dënuar në Pejë, por unë e di një gjë që gjatë gjykimit tonë, për tri ditë me radhë, Peja ka qenë në një situatë që çdo kush ka menduar vetëm për neve, ndoshta jo pse po dënoheshim një grup 'nacionalistësh', por pse po dënohej një grup shumica vajzash, një rast ky unikat që nuk mbahej mend në historinë e dënimit të organizatave të tilla atdhetare. Një veçori tjetër, mund të shquhej këtu mënyra sesi ne qëndruam dhe sesi u mbajtëm gjatë hetuesisë dhe qëndrimi që mbajtëm gjatë seancave gjyqësore.

Ndoshta ata kanë mundur të na lirojnë, sikur ne të thoshim se pendohemi për të gjitha ato që i kemi bërë, se nuk kemi qenë të vetëdijshëm për efektet e veprimeve tona, se ato kanë qenë të gabuara etj., por qëndrimi ynë ka qenë i prerë: se kërkesat tona ishin të drejta, ishin kërkesa historike të popullit tonë për të realizuar të drejtën e tyre për të jetuar si të tjerët, dhe më vonë u vërtetua që me të vërtetë kanë qenë shumë të drejta, gjitha ato përpjekje. Më në fund a nuk po i korrim sot rezultatet e ëndërrave të asaj rinie që, pos tjerash, Kosovën e mbronte në seanca gjyqësore dhe burgje serbe.

**Fehmi Hajra:** Ju e keni përmendur që në vitin 1984 keni qenë e dënuar më 5 vjet. A mund të na thoni më shumë për këtë? Ku jeni burgosur? Çfarë efekti ka pasur te ju?

**Myrvete Dreshaj:** E thashë pak më herët, që në muajt e fundit para se të burgosesha, ne vepronim shumë intensivisht, kishim krijuar kurajo të lartë, i besonim shumë vetvetes, ishim sistemuar bukur mirë, u solidarizim me të holla dhe blemë një makinë shkrimi, mësuam ta përdorim atë, blemë materialin, pastaj arrinim t'i fotokopjonim traktet dhe të gjitha këto sikur na vunë shumë në lëvizje, na vuri shumë në qarkullim ideja se edhe ne mund të bëjmë shumëçka sikur organizatat e tjera ilegale që vepronin në Kosovë.

Kështu që, shumë intensivisht filluam të bënim shkruarjen dhe shpërndarjen e trakteve, trakte të cilat kishin të njëjtën përmbajtje sikur traktet e të tjera të organizatave ilegale që vepronin në Kosovë. Ky intensitet u shtua aq tepër sa sigurisht ne, që ishim edhe më herët në regjistrin e organave të sigurimit, u arrestuam dhe u burgosem, kush në orë të mësimet e kush në shtëpi. Organet e sigurimit arrestuan edhe shumë nxënës të tjerë, do të thotë jo vetëm neve të nëntëve, të cilët pastaj krijuan një aktgjykim të përbashkët për neve, por u arrestuan edhe plot të rinj të tjerë të gjimnazit, për të cilët edhe sot i marr lakmi vetvetes sesi kemi arritur t'i mbrojmë dhe veprat e tyre, do të thotë të tresheve tona, t'i marrim përsipër vetëm vetë, se sigurisht kur krijuam këtë grupin ilegal prej nëntë vetave, secili kishte edhe celulën e vet, domethënë kishte edhe tre anëtarë të tjerë më të cilët organizohej dhe vepronte, dhe më vjen mirë se asnjëri prej tresheve tona nuk ka mbajtur burg, do të thotë krejt

veprimtarinë e kemi marrë përsipër vetë, ndërsa të tjerët janë liruar pas dy a tri orë hetimesh, ose një a dy ditë hetimesh, pra kanë qënë të lirë.

Fillimisht burgun e kam mbajtur në Mitrovicë, do të thotë periudha e hetuesisë është kryer në Mitrovicë, gati një vit të plotë. Pas shtatë a tetë muajsh ne kemi dalë në gjykim, këtu kemi edhe një koincidençë shumë të dhimbshme, për të cilën çuditërisht sot nuk po më mbushen sytë me lotë, njëherë tjetër kur e kam thanë më janë mbushur sytë plot lotë, por sot ..., ditën kur gjenerata jonë kishte maturën atë ditë ne dënoheshim. Do të thotë kjo ishte... ky informacion na erdhi disi brenda burgut dhe ne krejt çka kishim ishte një gotë plastike me ujë, dhe duke kërcitur në muret e njëra-tjetrës, me ato sinjalet që ne komunikonim brenda burgut, i uronim maturën njëra-tjetrës dhe gjeneratës sonë.

Fillimisht jemi dënuar më tepër, unë kam qenë e dënuar më 5 vjet, ndërsa më vonë Gjykata e Shkallës së Tretë na e ka bërë zbritjen e dënimit. Shoqja ime ka qenë e dënuar më 7 vjet, ndërsa Robert Rasaj, kryetari, udhëheqësi i grupit ka qenë më 8 vjet, Gjykata e Shkallës së Tretë pastaj ua ka bërë zbritjen e dënimeve edhe këtyre. Pas shpalljes së dënimit, pjesa tjetër e vuajtjes së dënimit, do të thotë periudha tjetër, pas një kohe, ka qenë në burgun e Lipjanit, do të thotë deri sa jam liruar kam qenë në burgun e Lipjanit.

**Fehmi Hajra:** A mund të na tregoni diçka rreth burgut ?

**Myrvete Dreshaj:** Edhe burgun e ka atë jetën e vet. Të burgosurit politikë në burgjet e ish-Jugosllavisë janë dalluar prej të tjerëve. Do të thotë si vazhdim të aktivitetit tënd kombëtar e ke menduar edhe qëndrimin e dinjitetshëm në burg, do të thotë të jesh e papërkulshme, të jesh e paepur, të jesh me qëndrim dinjitoz. Këto kanë qënë aspirata të cilat është dashur t'i përmbushë dhe është dashur t'i mbajë çdo i burgosur politik. Mua më vjen mirë prej gjeneratës sime dhe prej shokëve e shoqeve të grupit tim që kanë pasur një qëndrim shumë dinjitoz, me të cilin i kanë bërë me dije edhe organeve të sigurimit dhe njerëzve të tjerë të pushtetit jugosllav që më të vërtetë janë të vetëdijshëm për peshën e veprimtarisë së tyre dhe se janë të pathyeshëm në rrugën e tyre, pra kanë mbajtur qëndrim tërësisht madhështor që i takon një njeriu që duhet të mbajë atë rrugë të cilën edhe e ka filluar.

**Fehmi Hajra:** Mandej keni qenë anëtare në Lidhjen Demokratike të Kosovës në vitin 1990 ...?

**Myrvete Dreshaj:** Po pastaj ... duhet të hyjë këtu te mbajtja e burgut, lirimi prej burgut, peripetite për të kryer shkollën e mesme, ju thashë edhe më herët një peripeti e veçantë. U liruam gati që të gjithë të burgosurit e grupit tonë dhe të gjithë kishim atë aspiratën për të vazhduar më studimet. Ndërsa për të përfunduar shkollën e mesme ishte shumë e vështirë, na sillnin prapë në Gjykata, njëherë në Prishtinë, në Prishtinë na thoshin që është çështje e gjykatës komunale, gjykata komunale ishte e Pejës, ndërsa drejtori i gjimnazit tashmë ishte shqiptar, fatkeqësisht nuk ishte më serb, sikurse kur jemi burgosur, ndërsa ai s'na pranonte në provime.

Unë, më vonë gjeta një lidhje dhe u regjistrova në gjimnazin e Prizrenit, por krejt kjo më zgjati vetëm tri javë. Më përjashtuan edhe nga ky gjimnaz për shkak të papërshtatshmërisë politike. U ktheva prapë në Pejë. Filluan të njëjtat peripeti. Babai im që ishte një entuziast i madh i arsimit, ju thashë edhe më herët, tashmë nuk kishte më durim, ai përdori edhe kërcënimin ndaj organeve të sigurimit dhe drejtorisë së shkollës, ai tashmë ishte në gjendje të përdorte edhe forcën dhe këtë ua tha të dy palëve, se është në gjendje të shkojë deri në fund vetëm që këta fëmijë të përfundojnë shkollën e mesme.

Ndërsa, gjatë procesit gjyqësor prindërit tonë që ishin në Gjykatë patën kërkuar të dinë se a na humbet e drejta e shkollimit a jo, ne kemi qenë sigurisht shumë të rinj atëherë, dhe nga gjykata na është thenë se më t'u liruam do të kemi të drejtë të vazhdojmë shkollimin, por më vonë rrodhi se kishte qenë çështje frike personale e drejtorit të shkollës për gjithë ato maltretime që na dolën. Në organizimin e provimeve për ne gjithçka ka qenë e veçantë. Në provim bashkë me profesorin e lëndës asistonte edhe një nga sekretariati. Do të thotë edhe aty kemi arritur një sukses të mirë, unë e di që kam arritur të marrë pesëshe të gjitha, pos në Kimi që kam marrë katër, e ndoshta më shumë për shkak se edhe profesori i lëndës e kishte pasur vëllain e vet të burgosur politik, dhe haptazi e shihte se është duke u përcjellur, apo edhe ndoshta i mungonte kuraja për të më dhënë një notë më të lartë, dhe në Serbisht kam marrë tresh.

E, pastaj vazhdimi i fakultetit, dhe sigurisht me ardhjen në Prishtinë, këtu u njohëm edhe me njerëz të tjerë të ilegales, të cilët kishin mbajtur me plot vjet burg. Janë vitet 1989 e 1990, është koha kur me të madhe të burgosurit politikë liroheshin nga burgjet jugosllave, kishte edhe zbritje të dënimeve, neni 133 që ishte për "propagandë politike" me rënien e disa sistemeve komuniste në Evropën Lindore ra dhe ai, ndërsa brezi i të burgosurve të '81 po mbushte dhjetë vjet të mbajtjes së burgut të tyre politik. Do të thotë u lirua një pjesë e madhe e të burgosurve politikë dhe faktikisht Prishtina ishte ajo që i mblodhi prapë këta njerëz. Me disa u rinjohëm, me disa u njohëm, për disa veç kishim lexuar, kështu që prapë rifilluan ato celulatat e organizimit, megjithëse tani në forma më të ndryshme.

Në vitin '89 ishte formuar Lidhja Demokratike e Kosovës. Edhe hyrja në këtë parti kishte rreziqet e veta, sepse nuk ishte lehtë të hysh edhe të regjistroheshe anëtare e një partie, sidomos kur në biografinë personale kishe vite burgu, ndërkohë që edhe kjo parti mbahej për pastërtinë kombëtare, pretendonte të bëhej sinonim i një Lëvizjeje gjithëkombëtare etj. E ne me atë entuziazmin tonë hynim dhe troktnim në çdo derë të konviktit që të bëjmë fletanëtarë dhe t'i dërgojmë në Shoqatën e Shkrimtarëve, aty ku e kishte selinë LDK-ja.

Më vonë përmes procedurave të kuvendeve duke filluar nga aktivi, nëndegët, degët dhe kuvendi i përgjithshëm unë arrita që të renditem në këtë parti dhe të jam anëtare e Këshillit të Përgjithshëm. Kështu këtë pozitë e kam mbajtur për gjashtë vjet më radhë. Gjatë kësaj kohe jam marrë kryesisht me punë terreni, e jo më punët në qendër, me organizimin, me regjistrim e popullësisë, me organizimin e votimeve, me vizitat familjeve të veçanta dhe më nevojja të ndryshme, me shpërndarjen e ndihmave humanitare. Pra, jam marrë me krejt atë që ishte pjesa e jashtme dhe organizative e punës në terren për këtë parti. Në LDK kam qëndruar deri para Kuvendit të Tretë, do të thotë deri më 1996.

**Fehmi Hajra:** A mund të na tregoni diçka për synimin e saj, në kohën kur ju jeni anëtarësuar?

**Myrvete Dreshaj:** Për mua koncepti për këtë parti ka qenë i përgjithshëm. Jo idealet e saj, por mënyra e funksionimit të saj ka bërë të mundur që edhe brenda saj të zhvillohej një lëvizje e përgjithshme e idealistëve në Kosovë. Kështu e kam menduar deri në kohën kur unë kam dalë nga kjo parti. Për mua, kjo parti ka qenë një lëvizje e cila në mënyrë më legale bënte konceptin kombëtar për çlirimin e Kosovës. Ky ka qenë koncepti im i pranimit të kësaj partie dhe aktiviteti im nuk ka dalluar shumë prej aktivitetit ilegal dhe aktivitetit me hyrjen në Lidhjen Demokratike të Kosovës.

Këtu kam edhe një blic të shkurtë, kur erdha në studime prapë edhe njëherë më janë ndërprerë studimet, është viti 1989/90. Viti i demonstratave të mëdha, vit pas të cilit pason mbyllja e institucioneve të Kosovës, mbyllja e Universitetit, mbyllja e televizionit etj. Dihet që ka qenë vit i demonstratave shumë të përgjakshme në Kosovë, do të thotë ajo '81-ta përsëritet edhe njëherë. Dihet që në ballë të demonstratave kemi qenë edhe na, bile nga demonstrata që unë jam burgosur, dy rreshtat e para të studentëve, kur dolem nga Qendra e Studentëve, menduam që të jenë femra, me shpresë se policia nuk do të ndërvejojë ashpër dhe mund të arrijmë deri në qendër të qytetit, ku do të na bashkoheshin edhe qytetarët e tjerë.

Edhe pse menduam se policia nuk do të ndërvejojë kur të shoh dy rreshtat e parë të përbërë prej femrash, dhe në atë rreshtin e parë të femrave sigurisht që isha e renditur edhe unë me shoqet e tjera, policia mbylli hyrjen nga Instituti Albanologjik për të dalë në qendër. Ne u orientuam kah ish-posta nr.6. Arritem deri te gjysma e rrugës. Aty pastaj ka pasur një intervenim shumë të rreptë besa edhe të përgjithshëm të policisë. Vjen pastaj zbrapsja jonë, legjitimimi, arrestimi nga konvikti, marrja në hetuesi këtu në Prishtinë, pastaj pas tri ditësh qëndrim në Sigurimin Policor të Prishtinës, transferimi në Mitrovicë, po fati i madh, shumë i madh, nga përvoja që kisha ... arrita që të mbrohem duke u deklaruar se në demonstratë isha vetëm vetë, sepse qëllimi i tyre ka qenë që të krijojnë prapë një grup ilegal, që të na denojnë si grup.

Shihja veten që jam mjaft e përgatitur, kështu që për shoqet e mia të cilat u arrestuan bashkë me mua, arrita të them që s'i njoh dhe t'i bindi ata që s'i njoh, të mos dëshmoj dhe ato të lirohen dikush pas pesë, gjashtë orëve, dikush lirohet pas një dite, dy dhe në fund u ngrit një aktakuzë vetëm në mua për të cilën mbajta burg prej 30 tetorit të vitit 1989 deri më 3 janar 1990. Në kujtesë, nga legjitimimi dhe arrestimi që na është bërë në Qendrën e studentëve, më është fiksuar në këto momente, më shumë se gjithçka tjetër, pjesëmarrja edhe e mësimdhënësve të Universitetit në arrestimin tonë.

**Fehmi Hajra:** Dhe mandej keni qëndruar në LDK deri në vitin 1996?

**Myrvete Dreshaj:** Po, deri në vitin 1996.

**Fehmi Hajra:** Dhe aty i keni dhenë fund ...?

**Myrvete Dreshaj:** Po partive politike u kisha dhënë fund deri para një viti.

Shiko, pas daljes nga burgu do të thotë, ky burgu i dytë që ishte gjashtëdhjetë e tri a katër ditë, menjëherë kam vazhduar kërkimin dhe gjetjen e shoqeve dhe shokëve të mi, u jam bashkangjitur atyre në demonstratat që vazhdonim prapë, pra edhe gjatë muajve janar e shkurt, këto demonstrata kanë qenë shumë të përgjakshme sidomos në rrethin nga vij unë, Peja.

Këtu ka pasur plot të vrarë dhe të plagosur, do të thotë demonstratat kanë qenë shumë intenzive dhe rezistenca e shqiptarëve, pjesëmarrja dhe kohëzgjatja në këtë qytet është dalluar në krejt Kosovën. Dhe një gjë që ishte vendimtare për një aktivitet tjetër ka qenë pas përfundimit të këtyre demonstratave dhe me të vërtetë pas atij tmerrri dhe terrori që mbollen këto demonstrata. Unë e di që në shkurt të 1990, me mbylljen e televizionit, me mbylljen e Universitetit, me mbylljen e shumicave të shkollave të mesme dhe largimin e nxënësve nga ndërtesat, me largimin prej punës gati të të gjithë punëtorëve shqiptarë, me ato nënshkrimet që kanë qenë a je apo s'je për Serbinë, të gjitha këto situata historike që i ka pasur Kosova në '90-tën, kanë pasur për qëllim mbjelljen e frikës në zemrat e shqiptarëve.

Dhe gati për herë të parë prej që unë mbaj mend, sikur shqiptarët filluan të frikoheshin prej një terrori kaq të madh dhe kjo ishte gjëja ma e pakapshme dhe ma e ndjeshmja për neve, a është e mundur që popullit t'i ketë hyrë frika deri në palcë prej këtij terrori që u bë? E dimë atë pjesën e plumbave dum-dum që mbetën në shumë trupa të demonstruesve, pastaj ajo situata që dy njerëz ose tre nuk mund të ecin në rrugë së bashku, kështu që njerëzit filluan të mos duken fare, të qëndrojnë vetëm në shtëpi.

Tash ç'do të thotë, pa rrogë, pa punë, të mbyllur në shtëpi, një kolaps i vërtetë i shqiptarëve në ish-Jugosllavi. Njëkohësisht Serbia vazhdonte propagandën për shqiptarët si njerëz të papërshtatshëm për shtetin dhe të egër në sjellje dhe veprime. Në një gazetë, ishte një informatë e TANJUG-ut, lexojmë me shoqen time Havën, se vrasjet që bëheshin në demonstrata nuk ishin nga policia dhe ushtria serbe. Përkundrazi, shqiptarët po i shfrytëzonin demonstratat si arenë për të shtënë në mënyrë të pakontrolluar dhe për t'u hakmarrë për çështje gjaku e hasmërie.

Kjo ka qenë e tmerrshme për neve, ka qenë shokuese në njëfarë forme, a është e mundur që gjithë këtë terror që ata e bënë mbi ne tashi? e interpretojnë sikur ne ia kemi bërë vetvetes, sikur protestat, demonstratat janë arena ku po shiheshin shqiptarët dhe po hakmerreshin për gjaqet që i kanë pasur njëri-tjetrit. Dhe kjo nxiti atë ndjenjë, bëri ringjalljen e një bisedë që ne kishim pasur para disa vjetëve në burg, se a thua a mund të bëjmë diçka në pajtimin e gjaqeve, e kemi ditur që është një dukuri problemi i hakmarrjes në Kosovë dhe këtu, tashti, e përforcuam këtë sepse kishim një situatë shumë më të favorshme: demonstratat jo vetëm që kishim avancuar kërkesat gjithëkombëtare në nivelet më të larta, po ato bënë një ndryshim të madh edhe në shpirtin e njerëzve tanë.

Ky ndryshim bëhej shpeshherë brenda ditës dhe kështu dita matej me dekadën. Forca e gjakut të derdhur atyre ditëve ngjante në një forcë magjike. Kjo ishte ajo forcë, që i bënte të hasmuarit, pa urrejtjen e mëparshme të merrnin pjesë në të njëjtin varrim si në varrimin e Fatmir Ukës, Gani Dacit e dëshmorëve të tjerë në Pejë me rrethinë. Kjo ishte ajo forcë që bëri të pranohet pa përçmim femra

jonë në oda burrash dhe me respekt të dëgjohej fjala e saj. Kjo bëri që si një grup i të rinjve, të ballafaquar më parë drejtpërdrejt me dorasit, prapa grilave dhe në qelit e burgjeve serbe e jugosllave, nga ballafaqimi me vuajtjet e familjeve të tyre, me ankthin e vazhdueshëm nga rreziku i përrirjes së gjakut, të përforcojmë zanafillën e idesë për pajtimin e gjaqeve.

Edhe ashtu ndonjë aktivitet tjetër për kohën ishte i pamundshëm, demonstratat që bëheshin me gurë dhe përballë kishin plumba dhe tanke, ishin të pamundura të vazhdoheshin. Atëherë ky grupi ynë që ishte, unë bashkë me shoqen time Havën shkuam në odën e Adem Grabovcit dhe biseduam edhe me të tjerët: Brahim Dreshajn, Lulëzim Ethemajn e Ethem Çekun, se a mund të bëjmë diçka që së paku t'i themi kësaj Serbie dhe Jugosllavie, që shqiptarët në gjendje lufte gjithëherë e kanë pushuar aktivitetin e hakmarrjes dhe historikisht është e njohur kjo, që p.sh. nga Kanuni i Lekë Dukagjinit e kemi të njohur se në situata të veçanta historike shqiptarët kanë lidhur besën, kanë falur gjaqet, kanë kryer aktivitetin, e më vonë kanë vazhduar pjesën e zakonshme të jetës.

**Fehmi Hajra:** Le të flasim pak për Nismën për Pajtimin e Gjaqeve. Ju keni qenë një ndër nismëtarët. Cili ka qenë qëllimi kryesor i këtij organizimi, synimet, motivacioni?

**Myrvete Dreshaj:** Thashë edhe më herët që, në odën e Adem Grabovcit nuk është biseduar më për një pajtim si mendim, por për një vendim që ia vlen dhe duhet të ndërmerret në pajtimin e gjaqeve-hasmërive në mes njerëzve të popullit tonë. Kjo është e lidhur pra më fillimin e vitit 1990, brumi për të filluar ky aksion do të thotë ishin gjithë ato reprezalje që bëri Serbia, ajo stepja që bëme para vetvetes ne si shqiptar, ajo fara e frikës që mbollën, kurse ne menduam që edhe njëherë ta ringjallim shpirtin e guximshëm të shqiptarit, ta ringjallimin edhe njëherë atë guximin deri në sakrificë, deri në flijim, ishim idealistë të mëdhenj dhe së pari e vënim veten tonë në provë.

Plagët që na i shkaktonin të tjerët na dukeshin më të lehta se plagët që i shkaktonim vetvetes. Këtu, pra e krijuam bërthamën e parë të Aksionit të Pajtimin të Gjaqeve, ku u vendos që: falja e gjaqeve-pajtimi, të kërkohet në emër të dëshmorëve, të gjakut të tyre, në emër të popullit, të flamurit, të rinisë, në emër të unitetit kombëtar. Moto e përhershme e aksionit të jetë: kur na vrasin të tjerët, ne të mos i hapim varre vetvetes. Që 32 të vrasin nga terrori shtetëror serb t'i ringjallim duke i falur 32 gjaqe, duke i lënë të pahapura 32 varre të reja; të dilet në terren për t'i mbledhur shënimet dhe të dhënat komplete për familjet që gjendeshin në hasmëri gjaku, plage apo ngatërrese; të shfrytëzohen vizitat nëpër të pamet që ishin hapur për dëshmorët e rënë në propagandimin e nismës së Aksionit; gjatë bisedës me falësit të mos thelloheshim në rrethanat për të cilat kishte ndodhur vrasja, sepse çfarëdo qofshin ato, familjet kishin humbur njeriun e dashur, të birin, babanë, axhën, vëllain, motrën apo nënën; të theksohet se edhe me të vdekurit mund t'i shërbehet Kosovës e popullit; Aksioni i Pajtimin, pas rezultatevetë para, të shtrihet në të gjitha viset e robëruara shqiptare. U vendos që të bisedohet dhe të kërkohet ndihmë edhe nga të tjerët.

Bërthama e parë përbërëse e këtij Aksioni ishin ish-të burgosurit politikë, prandaj kërkua që LDK-ja së paku formalisht ta merrte përsipër këtë nismë, sepse si ish-të burgosur, mund të ndiqeshim e të

arrestoheshim dhe aksioni mund të ndërpritej që në nismë. Përgjegjësi i LDK-së në Pejë e çmoi aksionin por nuk e pranoi misionin.

Pas kësaj filluam të hynim në familje, së pari në lagjet tona, fshatrat përreth, qytet duke identifikuar të gjitha familjet që janë në hasmëri njëra me tjetrën, dhe pasi bëmë një regjistër atëherë ne menduam se mund të hymë në këto familje dhe t'i pajtojmë mes veti, t'i falin gjakun njëra-tjetrës, t'i falin ngatërresat, t'i falin edhe plagët. Filluam, por më thënë të vërtetën ne ishim të rinj, nga mosha prej 20 deri në 25, 26 vjet dhe ato rregullat e odës siç pamë ishin një shkollë në vete dhe aty e pamë se sado entuziastë, sado sakrifikues të jemi kemi nevojë për një pleqnar ode.

Atëherë ishte Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, i cili bënte një aktivitet të dendur dhe i cili u legjitimua si një lëvizje që vënte në mbrojtje popullin shqiptar në Kosovë, ndërsa kryetar a sekretar i Këshillit ishte Zekria Cana. Ne menduam të shkojmë e ta marrim Zekria Canën, që na dukej aq trim, aq njohës, aq përkrahës, në këtë aktivitet tonin. Erdhëm në Prishtinë dhe gjetëm Këshillin, gjetëm profesorin Cana, dhe i thamë kështu e kështu, u entuziazmuam me neve, nuk ishim edhe ne emra të panjohur për të.

Ai na tha, “Po,” menjëherë, por na tha se, “edhe unë besa frikohem prej odave se nuk i di mirë rregullat e odës, por kam një mik timin, i cili mendoj që do të na përkrah dhe i cili është njohës shumë i mirë i traditës dhe kulturës popullore, dhe ky është Profesor Anton Çetta”. Bashkë me Profesor Zekria Canën erdhëm në Institutin Albanologjik të Prishtinës, i tregojmë Profesorit Anton për nismën, kështu ai madhështohet nga ideja dhe thotë, “O Zot a është e mundur që ju do ta bëni këtë!” “Po, mundemi,” i themi ne, “kemi bërë evidencën e shumë punë të tjera, po ne kemi nevojë për një pleqnar, i cili është njohës i mirë i dokeve, zakoneve dhe traditës së odës”.

E, Anton Çetta, ishte mbledhës e studiues i mirë i folklorit, njëhte çdo odë të Dukagjinit po edhe të Rrafshit të Kosovës, ai thotë po unë do të ju bashkohem juve. Rasti i parë që zgjodhëm ishte në fshatin Lumbardh, ku së bashku më Profesor Anton Çettën dhe Zekeria Canën ishim edhe 21 të rinj, të gjithë ish të burgosur politikë. Dhe më datën 2 shkurt 1990 ne arritëm nga kryefamiljari Isa Leka të marrim besë për tre muaj. Kjo datë për ne shënon fillimin zyrtar të Aksionit të pajtimit. Kjo familje ishte në gjak me familjen e Smajl Lekës, të cilin e kishim njohur në demonstratat e janarit në Pejë.

Pasi policia kishte shpërndarë demonstratën, ne hymë një lokal ku Smajl Leka kishte kapur kokën me dorë mbi tavolinë. I afrohet shoqja ime Hava dhe e pyet se çka ka, mos i është vrrarë djali në demonstratë? “Jo,” thotë ai, “djemtë i kanë mbyllur në shtëpi sepse jemi në gjak me njërin, por kam frikë se mos kanë ikur dhe kanë ardhë këtu, e mos e thashtë Zoti të dalë Isa e na shkon fytyra dhe e knaqim hasmin”.

Atë ditë në këtë odë kemi qëndruar gati tërë ditën. Isa për orë të tëra ka qëndruar si i pagojë. Vetëm lëvizte kokën por përgjigje nuk jepte. Ligji i hakmarrjes peshonte më rëndë se argumenti jonë. Ato ditë atij ia kishte rrahur djalin policia keq bile...Në këtë pikë takohej dhembja jonë dhe e tij. Këtu i zbutej zemra, këtu plasaritej ligji i gjakmarrjes, që e kishte bërë të vrazhdë jetën e tij...

**Fehmi Hajra:** Domethënë ju e ftuat profesor Çettën?

**Myrvete Dreshaj:** Po, ne e ftuam profesor Çettën. Profesorin Anton e kemi pasur çdo të shtunë dhe të diel, në ditë vikendi, ndërsa pesë ditë të tjera kemi punuar ne grupi nismëtar, kemi përgatitur rastet, ndërsa këto dy ditë të javës, bashkë me të dy profesorët, i kemi mbyllur në mënyrë solemne rastet e përgatitura për falje.

**Fehmi Hajra:** Po Këshilli ishte legal, keni pasur lidhje me ta?

**Myrvete Dreshaj:** Po Këshilli për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut ishte legal, dihet. Po ne ishim një grup tjetër, Grupi Nismëtar për Aksionin e Pajtimin të Gjaqeve. Ne se kishim regjistruar atë, asgjë absolutisht që lë shenja të dallueshme haptazi ne nuk bënim, struktura organizative shkonte si e grupeve ilegale kur kemi vepruar. Fillimisht mbështetja ka qenë vetëm e profesorit Zekria Cana si individ që punonte në Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut. Po ne e kemi kërkuar një mbështetje pak më institucionale prej degëve së Lidhjes Demokratike të Pejës, por në fillim është hezituuar shumë, pak nga frika e pak nga mosbesimi...

Por punën e vazhdonim më tutje. U bë pajtimi i familjeve Buçolli në Raushiq, u fal gjaku në Broliq... I shihnim duke u përçafuar ata që vetëm disa çaste më parë ishin konsideruar hasëm mes veti. E, çdo gjak i falur ishte një kontribut më shumë në Lëvizjen tonë për faljen e të gjitha gjaqeve. Pajtimet u bënë pa kushtëzime. Gjaku u fal për burrëri. Dorëzan ishte Kosova e martirizuar, gjaku që derdhej për liri, flamuri, rinia e populli. Familjet që ishin në hasmëri u pajtuan sepse i besonin popullit të vet, i besonin profesor Antonit, i besonin sinqeritetit dhe çiltërsisë së rinisë. Aksioni shpejt kaloi caqet e një lokaliteti dhe mori fizionominë e një Lëvizjeje Gjithëpopullore, atij tashmë në përmasa të mëdha po i ofroheshin edhe të tjerë dhe intelektualë më emër.

**Fehmi Hajra:** Domethënë ka pasur jehonë, rezultat ?

**Myrvete Dreshaj:** Ka pasur jehonë shumë të madhe. Thashë prej janar-shkurtit kur tre njerëz së bashku nuk ke mundur t'i shohësh nëpër qytetet e Kosovës dhe në qytetin e Pejës, më 1 maj 1990 ne kemi arritur që 500 mijë njerëz, t'i mbledhim te Verrat e Llukës dhe kjo ka qenë një fitore e madhe, do të thotë u zbeh frika, populli mori prapë guximin, krijoi një homogjenitet dhe unitet mes veti. Dhe një gjë dua ta them, që gjithë ai që ka qenë pjesëmarrës në këtë tubim të madh të Pajtimin të Gjaqeve te Verat e Llukës e din që kemi qenë të rrethuar me tanke, dhe askujt nuk i ka ra në mend që është rrethuar dhe a do të dalë i gjallë prej këtij rrethimi, do të thotë ky aksion mbolli guximin deri në sakrificë të njerëzve dhe mendoj që aktiviteti më i madh i kësaj lëvizjeje ka qenë që shqiptarëve ju ka mbjellë guximin dhe trimërinë edhe njëherë, dhe se ata kanë qenë ndoshta në gjendje të hynë në luftë më homogjen sesa në vitin 1998, 1999 kur u bë lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

**Fehmi Hajra:** Po më intereson motivacioni juaj për pajtimin e gjaqeve?

**Myrvete Dreshaj:** Mendoj që ka qenë një si rinjohje e mirë e historisë. Në lëvizjen ilegale, ne së pari kemi shfletuar shumë historinë tonë kombëtare prej të cilës kemi kuptuar se kush jemi, nga jemi, prej nga vimë, cili popull jemi, do të thotë kemi pasur një përgatitje të mirë informative sa i përket historisë, gjenezës tonë si popull dhe kemi njohur mirë edhe Kanunin e Lekë Dukagjinit etj.

Verrat e Llukës nuk i kemi zgjedhur rastësisht, pikërisht aty ku më 1903, është bërë një besëlidhje shqiptare, pra kur kanë qenë në luftë me malazezët. Ne pikërisht e zgjodhëm këtë vend, sepse historikisht e njihnim historinë e tij. Tek shqiptarët, historia zakonisht përsëritet nga dekada në dekadë dhe ndoshta kjo logjikë bëri që edhe ne të bëjmë përpjekje për përsëritjen e saj. Ishte dhe një humanizëm, që i lidh njerëzit mes veti, i liron familjet, i liron fëmijët etj. Pra, kemi pasur raste vrasjesh si çdo kund, dhe ne edhe atëherë pretendonim që me to të merrej Gjykata, por ne e dinim edhe Gjykatat si ishin, jo të plota dhe jo krejt tonat, pastaj mund të merreshin me një, dy ose tre anëtarë, po jo me krejt familjen, e familjet tona dihet ishin shumë të mëdha. Dhe lirimi i familjes ka ka qenë ajo aspirata jonë.

**Fehmi Hajra:** A mendoni që ka ndodhur ndonjë veprim tjetër si rezultat i kësaj ngjarjeje?

**Myrvete Dreshaj:** Shiko gjatë Aksionit të Pajtimit të Gjaqeve, në të njëjtën kohë u bëmë bartës edhe të aksionit “Familja ndihmon familjen”, që lidhet me minatorët e Trepçës, Stan trgut. Për pajtime ne shkuam andej dhe pamë gjendjen e mjerueshme të minatorëve, gjendja e tyre ekonomike ishte shumë, shumë e tmerrshme dhe aty pastaj na lindi ideja të fillojmë edhe diçka tjetër dhe më përmbylljen e pajtimeve ne vazhduam aksionin “Familja ndihmon familjen”, synimi i të cilit ishte që familjet nga Rrafshi i Dukagjinit, me gjendje ekonomike më të mirë të lidheshin e të miqësoheshin më këto familje të minatorëve të Standërgut dhe t’u dilnin në ndihmë.

Me muaj të tërë vepruam me këtë aksion dhe lidhem shumë familje dhe më vjen shumë mirë kur edhe sot njerëzit kanë miqësi familjare dhe e ruajnë si të shenjtë atë. Domethënë kemi bërë disa ura lidhëse mes familjeve të minatorëve, të cilët në kohët më të vështira për ta, i janë ndihmuar materialisht, ekonomikisht dhe moralisht që të mos dorëzohen, në kohën që ju ka munguar edhe kafshata e gojës.

**Fehmi Hajra:** Kush i ka organizuar?

**Myrvete Dreshaj:** Përafërsisht të njëjtit njerëz që kemi qenë [në Lëvizjen për Pajtimin e Gjaqeve], por tashti dihet që ata 21 që i përmenda, në radhë të parë ai grupi prej 6–7 vetave e më vonë prej 20, pastaj ato “këshillat e pajtimit” që i kishim krijuar, shkonim nga 2-3 të grupit nismëtar në Mitrovicë, në Prizren, në Gjilan, dhe krijonim celulën, rrethin. Puna më e madhe që kemi bërë, është se kemi përfshirë Preshevën, Bujanocin, Tetovën, Gostivarin, Plavën e Gucinë, krejt trojet shqiptare, përgjithësisht, në të dy aksionet.

**Fehmi Hajra:** Kur ka ndodhur aktiviteti “Familja ndihmon familjen”?

**Myrvete Dreshaj:** Ka filluar aty nga fundi i vitit 1991 dhe ka vazhduar gjithë vitin 1992 e deri më 1993.

**Fehmi Hajra:** Keni përfshirë gjithë Kosovën?

**Myrvete Dreshaj:** “Familja ndihmon familjen” më shumë ka qenë i shtrirë në Rrafshin e Dukagjinit, por edhe më gjerë. Ndërsa Aksioni për Pajtimin e Gjaqeve ka qenë i shtrirë në të gjitha territoret shqiptare në ish-Jugosllavi.

**Fehmi Hajra:** Ka pasur rezultat ?

**Myrvete Dreshaj:** Ka pasur rezultat dhe unë thashë edhe më herët që edhe sot i gëzohem atij rezultati dhe kontakteve të atyre familjeve. Unë e di që tek ne është traditë në një pjesë të fashtrave tona njerëzit dalin në bjeshkë për tre muaj verë dhe unë kam parë plot fëmijë të minatorëve që këto familje i kanë marrë së bashku me fëmijët e vet dhe i kanë mbajtur nga tre muaj nëpër stanet e verës deri sa kanë zbritur edhe vetë. Ishte një vepër shumë e madhe që ata fëmijë të zbehtë të punëtorëve të Trepçës të mbahen andej.

**Fehmi Hajra:** Do të flasim edhe për aktivitetin tuaj në Shoqatën e të Burgosurve Politikë. A mund të na tregoni më shumë?

**Myrvete Dreshaj:** Pas daljes nga LDK-ja, unë kam hyrë në Shoqatën e të Burgosurve Politikë dhe në Kuvendin e Shoqatës jam zgjedhur në kryesinë e saj. Për kohën nuk mund të them që kemi pasur një aktivitet kumeditë sa të madh por jemi takuar së paku në dy javë, kemi biseduar për rrjedhat politike në Kosovë, kemi bërë evidentim, një regjistër të mirë të ish burgosurve politikë dhe të atyre që vuanin ende burgun politik, jemi përpjekë që me një ndihmë të vogël t'i dalim në krah ndonjë familjeje, anëtar i së cilës ende ishte duke vuajtur dënimin.

Po e di që kemi përcjellë realisht rrjedhat e ngjarjeve në Kosovë, fillimin e celulave të luftës në Kosovë. Më vonë prej kësaj shoqate kanë dalë në front të luftës edhe Ramë Buja, Gani Koci, Hydajet Hyseni, Ilmi Ramadani, Selatin Novosella, Berat Luzha dhe të tjerë. Do të thotë kemi qenë përcjellës besnikë të ngjarjeve në Kosovë, nëse hiç kurgjë, së paku jemi përpjekur të krijojë një opinion të drejtë dhe sa më realist për këto rrjedha të ngjarjeve në Kosovë.

**Fehmi Hajra:** Cili ka qenë synimi i Shoqatës?

**Myrvete Dreshaj:** Po këta njerëz të cilët kanë vuajtur dënime, kanë mbajtur burgje politike në ish-Jugosllavi të mos shkapërderdhen por të kenë një bërthamë, një qendër dhe adresë ku mund të orientohen, ku mund të mbledhen, ku mund të diskutojnë për aktivitetete të ndryshme, dhe ku mund të takohen mes vete. Unë e kujtoj kohën e protestave të Unionit të Studentëve, me të cilët është diskutuar në këtë Shoqatë, ju kemi dhënë përkrahje dhe kurajo. Unë kam qenë edhe pjesëmarrëse në to bashkë me studentët e mi. Do të thotë të gjithë njerëzit që janë orientuar në këtë Shoqatë, aty kanë gjetë atë mbështjetjen, kurajon, moralin për të vazhduar më tutje përpjekjet e tyre në luftën e përgjithshme për çlirimin e Kosovës.

**Fehmi Hajra:** Cilat janë sfidat dhe dilemat kryesore që keni hasur ju si politikane?

**Myrvete Dreshaj:** Po shiko nëse themi sfidat si gjini ka momente kur ...

**Fehmi Hajra:** Në përgjithësi ...

**Myrvete Dreshaj:** Fillova me gjini dhe po e vazhdoj. Ka momente kur nuk të bjen në mend absolutisht, hiç absolutisht për gjininë që ke, por në Aksionin për Pajtimin e Gjaqeve shpesh na ka ra që si gjini të ballafaqohemi sidomos me atë tradicionalitetin e odave. Vështirë nganjëherë jemi kuptuar, dhe në librin tim për pajtimin e gjaqeve unë kam disa kujtime të mia që tregojnë brumin e kësaj situatë.

Në oda kur kemi hyrë, ka pasur pleq të cilët fare nuk na e kanë zgjatur dorën, domethënëna kanë treguar se nuk është vendi i juaj këtu se ju duhet të shkoni te shtëpia e grave. Ndërsa shokët tonë që ishim me ta, e vërenin menjëherë këtë, ata në këso rastesh vetëm e hapnin bisedën ndërsa e vazhdonim ne vajzat. Është shumë e çuditshme, por ka pasur shumë pleq që këmbëkryq janë ulur në odë dhe gjithëherë e kanë gjetur pozitën me shpinë nga ne, që ne të qëndrojmë pas shpinës së tyre.

Ndërsa ne duke folur, duke treguar misionin, duke kërkuar faljen e gjakut ata dalëngadalë kanë filluar të bëjnë lëvizje dhe në momentin e fundit janë gjendur ballë për ballë me neve. Kjo, për ne si gjini ishte edhe një fitore tjetër shumë e madhe, fitore e gjinisë, sepse ata harronin se jemi ne femrat që po e kërkonim faljen e gjakut, dhe në momentin e fundit kur ne kërkonim që bashkë më ta, të shkonim edhe në shtëpinë e grave dhe t'i pyesim a janë dakord edhe gratë që të falin gjakun, sepse dikush ka mundur me e pasë djalin, dikush burrin të vvarë, për ta ishte shumë madhështore dhe ishte një kërkesë që përherë të parë ju ndodhte atyre dhe nuk e refuzonin atë.

Ndërsa kur vinim në odë bashkë me shokët tanë, ka pasur shumë pleq që kanë thënë se pari do t'ju zgjatim dorën këtyre burrneshave e pastaj juve. Kjo ishte një fitore shumë e madhe, të cilës i hynim me tremë, por në fund dilnim me një rezultat shumë të madh.

**Fehmi Hajra:** Domethënë dilema, sfida tjera nuk keni pasë ?

**Myrvete Dreshaj:** Po sigurisht, secila pjesë ka dilemat dhe sfidat e veta, të cilat në këtë bisedë tonën janë thënë disa herë ...

**Fehmi Hajra:** Po flasim si politikane, kur keni qenë më aktive në politikë?

**Myrvete Dreshaj:** Shiko kjo pjesa e vështirësive lidhet më kohën e veprimit intensiv kur as edhe pesë minuta nuk e ke pasur jetën të sigurt dhe kjo nuk ishte e lehtë. Do të thotë e gjithë kjo pjesa e fillimit të Aksionit të Pajtimit të Gjaqeve është bërë në orë policore dhe ne e dimë që Kosova ka pasur orë të plota policore, nga 6 e mbrëmjes e deri në gjashtë të mëngjesit.

Kurse ne në këtë pjesën e orës policore kemi vepruar, kemi hyrë shtëpie më shtëpi, kemi evidentuar, kemi përgatitur rastin për faljen e gjakut, do të thotë kanë qenë momentet kur nuk e ke ditur pas pesë minutash a do të jesh gjallë apo s' do të jesh gjallë.

Por, megjithatë dilema, hamendje para vetvetes se a do të vazhdojmë më tutje apo të ndalemi këtu, e di që rrallë herë na kanë ndodhur, se gati nuk kemi pasur fare. Do të thotë kemi qenë tamam idhtarë të punës sonë dhe kemi pasur bindjen që jemi duke e bërë një punë të drejtë dhe një punë shumë pozitive dhe të nevojshme për kombin tonë. Domethënë hamendje dhe dilema a të vazhdojmë tutje nuk ka pasur, sfida, vështirësi, peripeti dihet që ka pasur mjaft. Një pjesë e shokëve dhe miqve të mi sot nuk janë me të gjallët. Ata janë vrrarë. E disa janë pa ndonjë pjesë të gjymtyrëve të trupit.

**Fehmi Hajra:** Ju jeni aktive edhe sot në politikë. Çfarë ju motivon?

**Myrvete Dreshaj:** Kësaj që i themi politikë e sotme, pjesëmarrje në një parti politike, me përfundimin e luftës, unë fillimisht iu kam kthyer aktivitetit tim shkencor, punës sime profesionale dhe arsimore, kam dalë nga politika. Kam thënë që Kosova ka mjaft njerëz, të cilët mendojnë për politikën, e mendojnë edhe si profesion. Ju kam rikthyer shkencës, kam bërë magistraturën, kam përgatitur doktoratën, kam punuar në Universitet dhe kam thënë tash është shumë më lehtë të bëhet politika, nuk ka më “jetë a vdekje”.

Do të thotë duhesh të jesh i mençur, duhesh të jesh i përgatitur, duhet të ndjesh për të bërë politikën. Këtë qëndrim kam mbajtur deri më 2004, para zgjedhjeve të dyta nacionale kur vendosa të kthehem prapë në politikë, duke e kuptuar mundësinë time për të dhënë ende në emër të atyre idealeve për të cilat isha angazhuar vite më parë. Këto katër-pesë vjetët e pas luftës në Kosovë, kam shikuar strukturat e njerëzve të angazhuar në politikë dhe i kam thënë vetes se mund të vazhdoj edhe më tutje, se edhe më tutje mund të jap një kontribut timin, kështu që kam hyrë në Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, e cila i organizonte zgjedhjet e partisë për deputetë në Parlamentin e Kosovës me listë të hapur. Për nga numri i votave jam renditur e gjashta në listë. Domethënë motivi ishte që mund të bëj ende në politikë, mund të jap ende, do të thotë kam një brumë që e kam zënë me kohën, të cilin mund ta shfrytëzojë ende dhe që mund të ketë rezultate prej tij.

**Fehmi Hajra:** Cili është mendimi juaj për rolin aktual të gruas në politikë?

**Myrvete Dreshaj:** Shiko tashi të themi për një rol të veçantë apo të shkëputur nuk mund të themi, edhe roli i gruas është si roli i burrit. Unë mendoj që gruaja nuk mbetet pas burrit, as me përgatitjen as me aftësitë, bile bile në momente të caktuara mendoj që është më e përqëndruar, më e kujdesshme, më këmbëngulëse, më e natyrshme dhe më e përkushtuar.

Sa për dekor gruas nuk ka nevojë t'i jepet pozitë, nuk ka nevojë të gjindet aty si kukull, ne e kemi një 30 përqind në Parlament, të cilin e kemi dëgjuar që sa vite të komentuar në mënyra më të ndryshme, do të thotë për shkak se është imponuar, për shkak se OSBE-ja ka vendosur kështu. Unë nuk mendoj

ashtu. Unë e shoh, se për këta dhjetë muaj që jam në Parlamentin e Kosovës, nuk dallon gruaja prej burrit, të njëjtat aftësi, të njëjtat përgatitje i ka sikurse të tjerët.

Do të thotë nuk kemi asnjë dallim absolutisht, gruaja zgjedhet me vlerën jo për atë pse është e një gjinie, dhe absolutisht mendoj se nuk duhet t'i jepet përparësi pse është e një gjinie por as të ketë nuanca diskriminuese për shkak të gjinisë. Edhe asaj t'i jepet përparësi vetëm në bazë të meritës, ndërsa këtu mendoj se burrat janë më shpirtngushtë, e sidomos aty ku ndahen pozitat aty ka pak zemërgjerësi për gratë.

**Fehmi Hajra:** Keni diçka për të shtuar për gjithë këtë që biseduam, për gjithë aktivitetin tuaj politik, kombëtar?

**Myrvete Dreshaj:** Nuk e di. Ne bëme një bisedë, një kujtim sikur që do ta kisha bërë më një shoqe timen të aktivitetit ose me një prej shokëve të mi. Sigurisht që ka mbetur edhe diçka pa u thënë por për momentin nuk më kujtohet.

**Fehmi Hajra:** Zonja Myrvete Dreshaj, ju faleminderit!